

## LETËRSIA SHQIPE MES DY LUFTËRAVE BOTËRORE NË KONTEKST EVROPIAN

**Mirlinda KRIFCA-BEQIRI<sup>1</sup>**

<sup>1</sup>*Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology "Blazhe Koneski", University "Ss. Cyril and Methodius" -  
Skopje*

<sup>\*</sup>*Corresponding author e-mail: mirlindakrifca@yahoo.com*

### **Abstract**

The Albanian literature between the two world wars stays a very provocative period for its researchers. It's characterized with a literary polyphony that makes it really special. The Albanian authors of this period, feeling the delayed character of the Albanian literature of the time, they will feel the need to go beyond the boundaries of the traditional literature and to communicate with schools and new literary voices. Therefore, the study of Albanian literature of this period, by itself, imposes the need of the study of its rapport with developed European literature, with whom the literature of this period shows a more intensified rapport.

The authors of Albanian literature of this period feel the need to separate from ideological influence, a characteristic for their ancestors and to be put in service to the artistic level. They bring fracture, for which the literature of the time needed. The big authors of the Albanian literature of the time between the two world wars will get in an open literary dialogue with chosen European literature or with writings of chosen authors, which serve as soul teachings. But, however the densely and the most fruitful dialogue with the European literature, the Albanian literature of this time does not detach from its national sole, achieving that, regardless of the acceptance of the new literary currents, however it saves its own characteristics, to preserve her physiognomy.

### **Përmbledhje**

Letërsia shqipe mes dy luftërave botërore mbetet një periudhë shumë provokuese për studiuesit e saj. Ajo karakterizohet me një polifoni letrare që e bën shumë të veçantë. Autorët shqiptarë të kësaj periudhe, duke ndjerë karakterin e vonuar të letërsisë shqipe të kohës, do të ndjejnë nevojën që të dalin jashtë kufijve të letërsisë së traditës dhe të komunikojë me shkolla dhe zëra të rinj letrar. Prandaj, studimi i letërsisë shqipe të kësaj periudhe, vetvetiu, imponon nevojën e studimit të raportit të saj me letërsitë e zhvilluara evropiane, me të cilat letërsia e kësaj periudhe dëshmon një raport më të intensifikuar.

Autorët e letërsisë shqipe të kësaj periudhe ndjejnë nevojën të shkëputen nga ndikimi ideologjik, karakteristik për pararendësit e tyre dhe të vihen në shërbim të rrafshit artistik. Ata sjellin atë thyerje, për të cilën kishte nevojë letërsia e kohës. Autorët e mëdhenj të letërsisë shqipe mes dy luftave botërore do të hyjnë në dialog të hapur letrar me letërsi të caktuara evropiane apo me vepra të autorëve të caktuar që u shërbejnë si mësues shpirtëror. Por, pavarësisht dialogut të dendur dhe më të frytshëm letrar me letërsitë evropiane, letërsia shqipe e kësaj periudhe nuk shkëputet nga tabani i saj kombëtar, duke arritur që, pavarësisht pranimin të rrymave të reja letrare, megjithatë t'i ruajë tiparet e veta, ta ruajë fizionominë e saj.

Letërsia shqipe mes dy luftërave botërore është shumë e veçantë. Në të gjejmë një spektër të gjerë stileshe e shkollash letrare dhe një numër të madh autorësh që, pavarësisht se krijuan në të njëjtat rrethana, zgjodhën rrugë të ndryshme për të shprehur dridhjet e veta artistike. Letërsia shqipe e kësaj periudhe, me larushinë e shkollave dhe stileve, me nëntekstin e fortë, me strukturën e arrirë figurative e ritmike, me shprehjen të artikuluar dhe me frymën emancipuese që sjell, mbetet shumë sfiduese për studiuesit e saj. Në të vijnë në shprehje elemente të formacioneve të ndryshme stilistikore që e bëjnë heterogjene.

Bëhet fjalë për periudhë letrare që kishte nevojë për tone të reja dhe që u mundua të paraqesë sintezë të gjithë asaj që në qarqet letrare evropiane ishte bërë për dekada me radhë. Pikërisht ky mëtim shpjegon hapjen më të theksuar të saj karshi ndikimeve të huaja, gjë që dëshmon, në radhë të parë, njohje, zotërim të vlerave të letërsisë evropiane, madje edhe asimilim të tyre. E kemi të njohur se procesi i afrimit të letërsisë shqipe me letërsinë e mëdha evropiane kalon: “. . . nëpërmjet dy rrugëve të mundshme: asaj të tipareve të përbashkëta mes tyre dhe asaj të tipareve të ndryshme, . . . ,”<sup>284</sup>

Shkrimtarët shqiptarë të kësaj periudhe duke u shkolluar apo jetuar në vende të ndryshme evropiane, do të vijnë në kontakt me shkolla të ndryshme filozofike apo letrare dhe do të arrijnë të vërejnë se mbrumja e brumit të letërsisë shqiptare është më e ngadalshme dhe më e vonuar në krahasim me atë të letërsive të mëdha evropiane, ndaj mundohen, secili sipas afiniteteve të veta, të vendosë një formë komunikimi me letërsinë e mëdha evropiane apo me personalitete letrare, me veprat e të cilëve kishin pasë kontakte më të përafërta; të vendosë një formë të dialogut letrar që, në përgjithësi, është dëshmuar, jo vetëm intensiv dhe kompleks, por njëherit edhe spontan, i natyrshëm, ndaj edhe i frytshëm.

Prandaj, studimi i letërsisë shqipe të kësaj periudhe imponon nevojën e studimit të raporti të saj me letërsinë evropiane e më gjerë, meqë intensifikimi i dialogut letrar të letërsisë shqipe me letërsinë e zhvilluara evropiane dëshmon edhe njëllëj përafrimi mes tyre. Në letërsinë e zhvilluara evropiane, sidomos nga gjysma e dytë e shek. XIX kishin ndodhur revolucione të vërteta artistike, veçmas lidhur me formën, meqë letërsia paraqitet si fushë eksperimentesh e tendencash për të sjellur novitete. Krijuesit e saj mëtojnë strukturë më dinamike të shprehjes poetike, strukturë më të arrirë ritmike dhe figurative, më eufonike dhe shprehje më të artikuluar letrare.

Përkundër tyre, letërsia shqipe na vjen me një trashëgimi letrare, krijuesit e mëdhej të së cilës ishin edhe autorë edhe edukatore; edhe krijues edhe ideologë. Ndaj, autorët e letërsisë shqipe të kësaj periudhe, të vetëdijshëm për karakterin e vonuar të letërsisë shqipe dhe ballkanike në përgjithësi ku, jo vetëm letërsia, por edhe koha nuk ecte me ritme të njëjta, mundohen, secili në mënyrën e vet dhe duke u mbështetur në njohuritë dhe afinitetet e veta, të ndikojnë në ecejakjen e saj të shpejtuar. Letërsia shqipe e kësaj periudhe: “. . . po e ndjente edhe teorikisht nevojën e ndryshimit, nevojën e kapërcimit të romantizmit rilindës dhe të kredhjes nëpër të tjera ujëra, nëpër të tjera rryma.”<sup>285</sup>

Këtë duhet kërkuar arsyen se pse në letërsinë shqipe tendencat e reja stilistikore nuk vijnë në kronologji dhe në formën e tyre të pastër si në letërsinë e zhvilluara evropiane, por vijnë të sintetizuara. Shumëzëshmëria letrare e kësaj periudhe e vështirëson mundësinë e emërtimit me nocionin e një formacioni stilistikor, meqë në të gjejmë elemente të shkollave të ndryshme letrare jo vetëm nga një autor te një tjetër, por edhe te po i njëjti autor. Kjo periudhë: “*Mund të pagëzohet, prandaj, si periudhë e një letërsie që shtrihet mes romantizmit, realizmit dhe simbolizmit, duke nënkuptuar me këtë togfjalësh edhe hapësirën, që shtrihet mes tyre, në të cilën shfaqen edhe elemente e prirje të shkollave dhe të rrymave të tjera letrare, si të parnasizmit, të neoklasicismit dhe të ekspresionizmit*”<sup>286</sup>

<sup>284</sup> Aurel Plasari, *Letërsia dhe muret*, Zëri i rinisë, Tiranë, 1993, f. 13.

<sup>285</sup> Ali Xhiku, *Letërsia shqipe si polifoni*, A. Sh. Sh., Dituria, Tiranë 2004, f. 32.

<sup>286</sup> Rexhep Qosja, *Shkrimtarë dhe periudha*, ASHSH, Tiranë, 2005, f. 53.

Autorët shqiptarë të kësaj periudhe komunikojnë me njëri-tjetrin, por pa pretenduar të ndryshojnë njëri-tjetrin, të bindur se çdokush ka të drejtë ta ruajë zërin e vet dhe t'ia bashkëngjesë atë korit të letërsisë shqipe të kohës. Veprat letrare të Migjenit, L. Poradecit, Gj. Fishtës, M. Kutelit, F. Nolit, E. Koliqit, E. Haxhiademit apo Asdrenit, secila më e mirë se shoqja, dallojnë shumë nga njëra-tjetra, meqë nisen nga poetika të ndryshme. Letërsia shqipe, sidomos ajo e viteve `20 dhe `30: “. . . kishte hyrë në një etapë të re. Vërshimi i ideve të reja nga jashtë dhe niveli më i lartë i shkollimit ndër intelektualët, i hapi portat kanat drejt përparimit kulturor. Për një dhjetëvjeçar, letërsia dhe kultura shqiptare lulëzuan si kurrë ndonjëherë...”<sup>287</sup>

Autorë të caktuar, duke ardhë në kontakt me rryma të caktuara letrare, do të mundohen, secili në mënyrën e vet, të kontribuojë në emancipimin e fjalës së shkruar, në lidhjen mes formës dhe përmbajtjes, në mëtimin që fjala të jetë, jo vetëm bartëse e një kuptimi të caktuar, por edhe e një melodie të caktuar, ashtu siç kërkohej që artisti të flet me gjuhën e shpirtit, para se të flasë me gjuhën e kombit, pra fjala artistike para se të jetë në shërbim të ideve apo detyrave kombëtare, të jetë në shërbim të vetes dhe të idealit artistik. Autorët e mëdhenj të letërsisë shqipe të kësaj periudhe e ndjenë nevojën të shkëputet nga rrafshi ideologjik në shërbim të të cilit, për shkak të rrethanave të njohura, ishin vënë pararendësit e tyre dhe të vihen në shërbim të rrafshit artistik. Ishte kjo koha kur: “*Letrat shqipe prisnin me ngut ardhjen e shkrimtarëve novatorë, ata që do të thyenin rutinën, që do të zgjeronin venat e saj të ngushtuara . . . , që do t'u rikthenin fjalëve lirinë e humbur.*”<sup>288</sup>

Letërsia shqipe e kësaj periudhe, duke u krijuar: “. . . në një qark të veçantë kulturor e historik, në një kontekst të ndryshueshëm kombëtar, politik e shoqëror”,<sup>289</sup> është e natyrshme të ballafaqohet edhe me kërkesa të veçanta. Ajo fillon t'i kthehet vetes dhe të sjellë një thyerje të pritshme dhe të dëshiruar, gjithmonë duke mbajtur llogari që me këtë të mos preket dhe dëmtohet fizionomia e saj, palca e saj shqiptare, gjegjësisht të mos tëhuajsohet nga tabani i saj kombëtar. Ndaj, studimi i kësaj faze të letërsisë shqiptare, vetvetiu, imponon nevojën e studimit të raporteve të sistemit letrar shqiptar me polisistemin letrar evropian, pavarësisht se me kohë, ky sistem “. . . e forcon gjithnjë e më shumë autonominë e vet”.<sup>290</sup>

Shumë shkrimtarë shqiptarë të kësaj periudhe i fillojnë hapërimet e veta të para si romantikë, për të përqaftuar, me kohë, elemente të realizmit apo të modernies. Kjo meqë, derisa modernia në letërsinë e zhvilluara evropiane dilte nga çintegrimi i realizmit, letërsia shqipe edhe nuk kishte pasur ndonjë realizëm të zhvilluar në kuptimin e plotë të fjalës. (Mjeda dhe Çajupi, sidomos në fillim ishin shumë të ndikuar nga romantizmi, kurse Asdreni bën hapin e parë drejt modernies). Pavarësisht respektit që ndjenin ndaj autorëve të mëdhenj të traditës shqiptare, sidomos ndaj Naim Frashërit, autorët e kësaj periudhe ishin të vetëdijshëm se koha e re imponon nevojën e prurjeve të reja letrare, prurje këto për të cilat nuk mjaftonte vetëm mbështetja në mësuesit shpirtëror nga tradita shqiptare.

Pra, ata ndjenin se kishin nevojë edhe për mësues të rinj, përfaqësues të rrymave të reja letrare të kohës. Prej tyre do të mësojnë, jo vetëm mjeshtërinë e vargut dhe thellësinë e simboleve, por edhe forma të reja të qasjes ndaj temave apo çështjeve që ishin trajtuar edhe më parë. “*Me veprën e Migjenit, me lirikën e viteve 20-30 të Asdrenit dhe me lirikën e L. Poradecit, letërsia shqiptare emancipohej nga trysnia e poetikës tradicionale dhe artikulonte shprehjen e saj moderne.*”<sup>291</sup>

<sup>287</sup> Robert Elsie, *Letërsia shqipe, një histori e shkurtër*, Skanderbeg books, Tiranë 2006. f. 159.

<sup>288</sup> Ismail Kadare, *Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe*, 8 Nëntori, Tiranë, 1991, f. 87.

<sup>289</sup> Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, ALB-ASS, Tiranë, 2000, f. 17.

<sup>290</sup> Kristaq Jorgo, “Letërsia shqiptare ndërmjet dy luftërave botërore në kontekstin evropian”, Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Eurorilindja, Tiranë, 1995, f. 323.

<sup>291</sup> Jorgo Bullo, *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, Dituria, Tiranë 1998, f. 67.

Kjo vërehet sidomos në interesimin që autorët e kësaj periudhe tregojnë ndaj mitit, me të cilin kishin komunikuar edhe paraardhësit e tyre, por mënyra e komunikimit të tyre me mitin do t'u përgjigjet kërkesave të kohës së re, meqë: “*Miti është një realitet kulturor jashtëzakonisht kompleks, të cilit mund t'i qasësh dhe ta interpretosh nga këndvështrime të ndryshme dhe përplotësuese*”.<sup>292</sup> Fundja, kjo ishte kohë që kishte nevojë për krijues të rinj dhe që lindi krijues të tillë. Një pjesë e krijuesve të mëdhej të kësaj periudhe ishin të vetëdijshëm për vështirësitë e receptimit të artit të tyre, i cili kërkonte dhe provokonte një horizont të ri të pritjes që nuk mund të formohej brenda natës, aq më tepër në një mjedis ku ishte gati i padëgjueshëm zëri i dimensionit të katërt të komunikimit estetik - kritikës.

Kjo makinë vlerësuese nuk ishte e gatshme të masë peshën e një pjese të mirë të veprave që botoheshin në këtë kohë. Ajo ndjehej e paarritur mjaftueshëm për të gjykuar mbi ta, ndaj i duhej kohë për të rritur kapacitetin e vet për vlerësimin e kësaj materie të veçantë e befasuese. Ajo, thjeshtë, kishte nevojë për riparim e risi. Krijuesit shqiptar që sollën tone të reja ishin të vetëdijshëm se ajo pak kritikë që shkruhej e botohej në mjedisin shqiptar nisej nga parime të vjetëruara mbi artin, parime këto që dallonin nga parimet që ata i kishin përqaftuar dhe që mundoheshin t'u shërbejnë. Ata kishin zgjedhur një rrugë që dallonte nga rruga e mjaft kolegëve të tyre që kërkonin që arti edhe më tej të vihet në shërbim të realitetit.

Ndryshimet që kishin ndodhur në realitetin shqiptar u mundësonin që të mos kenë nevojë ta sakrifikojnë artin e tyre për ta ndihmuar çështjen kombëtare që tani më ishte zgjidhur, ndaj atyre u takonte barra që ta nxirrnin artin nga qorrsoakët dhe ngushticat ku gjendej. Ata pranonin koncepte të reja krijuese, duke: “. . . *patur si karakteristikë të parë letrare theksimin e individualitetit krijues, të subjektivitetit në shkrimin letrar dhe shfaqjen e një ndjeshmërie të re*”.<sup>293</sup>

Letërsia shqipe e kësaj periudhe karakterizohet me qëndrim të ri ndaj gjuhës dhe muzikalitetit të saj; ndaj figurës artistike që na vjen më e latuar; ndaj historisë që shpaloset dhe rishqyrtohet në një mënyrë të re; ndaj mitologjisë, figurat e të cilës të aktualizuara dhe risemantizuara fitojnë funksion të ri; ndaj toposeve tradicionale që duke u risemantizuar, fitojnë vlerë të re që i përgjigjet senzibilitetit dhe nevojave të kohës së re. Është kjo letërsi që karakterizohet me struktura dhe forma të reja letrare dhe që krijon vetëdijen se letërsia duke qenë art, në radhë të parë, duhet të jetë në shërbim të vetes. Ishte kjo një nga ata periudha letrare kur: “. . . *letërsia, me shtrirjen dhe larminë e strukturave letrare, shfaqet si një tërësi komplekse*.”<sup>294</sup>

Autorët shqiptar të kësaj periudhe kanë qëndrime të ndryshme ndaj hipotekstivitetit në të cilin mbështeten. Në mesin e tyre nuk mungojnë autorë që vuajnë nga frika e ndikimeve të cilat mundohen që t'i fshehin në mënyra nga më të ndryshmet, ashtu siç nuk mungojnë edhe autorët që janë të vetëdijshëm se nuk është e rëndësishme se nga e marrin brumin e veprave të tyre, por si e asimilojnë, transformojnë, risemantizojnë, mbarështrojnë atë. Duke nisur nga bindja se autor plotësisht origjinal nuk ka pasur dhe nuk do të ketë dhe se të gjithë, në një mënyrë apo në një tjetër, mundohen të lënë gjurmë në pëlhurën e madhe letrare, ata nuk vuajnë nga kompleksi i “origjinalitetit” dhe nuk i fshehin burimet e tyre.

Autorët shqiptar të periudhës mes dy luftërave botërore, pos dialogut shumë të dendur dhe të frytshëm me kontekstin shqiptar, me folklorin, me Biblën, me mitologjinë (qoftë ajo shqiptare apo e huaj), me letërsinë antike greke e romake dhe me letërsinë shqipe të traditës, mbështeten në letërsitë e huaja evropiane, me të cilat kishin qenë në kontakt. Kështu, treshi i njohur i shkrimtarëve që jetuan e vepruan në Rumani – Asdreni, L. Poradeci dhe M. Kuteli vijjnë në kontakt me letërsinë rumune, si me veprën e M. Emineskut, G. Kushbukut dhe I. L.

<sup>292</sup> Mircea Eleade, *Miti dhe realiteti*, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2019, f. 13.

<sup>293</sup> Sabri Hamiti, *Po aty*, f. 11.

<sup>294</sup> Floresha Dado, “Periodizimi”, në *Sfida teorike të historiografisë letrare*, Bota shqiptare, Tiranë, 2011, f. 210.

Karaxhales, ashtu siç vijnë në kontakt edhe me letërsinë gjermane e franceze (Poradeci) apo me atë ruse (Kuteli).

E. Koliqi vjen në kontakt, në radhë të parë, me letërsinë italiane të traditës e të kohës, veçmas me veprën e D. Aligierit, F. Petrarkës, Xh. Karduçit e Xh. Paskolit. Vepra e Ali Asllanit, pos modelit të saj oriental, me kohë, gjithnjë e më shumë si model pranon poezinë frenge. Vepra e Gj. Fishtës, nga letësia e huaj, pos në letërsinë klasike edhe atë klasiciste evropiane, mbështetet edhe në letërsinë e sllavëve të jugut, si në veprën e P. P. Njegoshit dhe I. Mazhuraniqit. Në veprën novatore të Migjenit vërehet jehona e ndikimit nga letësia ruse dhe ajo e sllavëve të jugut, sidomos nga vepra e shkrimtarit të madh kroat, M. Kërlezha.

Vepra e intelektualit shqiptar të përmasave evropiane, F. Konica dëshmon mbështetje në kulturën e tij të gjerë nga historia, letësia dhe arti në përgjithësi, duke filluar nga Eskili deri te Ruzhe dhe Lil dhe S. Mallarme e G. Apolineri. Numri i mësuesve të tij shpirtëror është shumë i madh, ashtu siç është e madhe edhe fuqia e tij asimiluese dhe transformuese. Miku i tij, shkrimtari i afiniteteve të larta intelektuale e kulturore, Fan Noli, si mësues shpirtëror pati shkrimtarët e mëdhenj botëror të cilët i shqipëroi.

Etëhem Haxhiademi, nga ana tjetër, nëpërmjet të kthimit në mit apo në histori mundohet, jo vetëm të shpreh pakënaqësinë nga realiteti, por edhe të dëshmojë se mitet trajtojnë tema me karakter universal, ngjarje dhe heronj që, me transformime të vogla përsëriten në të gjithë kohët e mjediset. Nga gjitha ajo që u tha më sipër, mund të përfundojmë se: *“Në të vërtetë jeta letrare e viteve 20 e 30 në Shqipëri ishte mjaft e pasur dhe interesante. Siç ndodh shpesh me kohërat e zgjënjeve, kjo epokë, si për drejtpeshim të gjërave, duke qenë shterpe në gjithçka, jepte letërsi të madhe”*.<sup>295</sup>

## Referencat

- [1]. Bulo, Jorgo, *Magjia dhe magjistarët e fjalës*, Dituria, Tiranë 1998.
- [2]. Dado, Floresha, *Sfida teorike të historiografisë letrare*, Bota shqiptare, Tiranë, 2011.
- [3]. Eliade, Mircea, *Miti dhe realiteti*, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2019.
- [4]. Elsie, Robert, *Letësia shqipe, një histori e shkurtër*, Skanderbeg books, Tiranë, 2006.
- [5]. Hamiti, Sabri, *Letësia moderne shqiptare*, ALB-ASS, Tiranë, 2000.
- [6]. Jorgo, Kristaq, “Letësia shqiptare ndërmjet dy luftërave botërore në kontekstin evropian”, *Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Eurorilindja, Tiranë, 1995.
- [7]. Kadare, Ismail, *Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe*, 8 Nëntori, Tiranë, 1991.
- [8]. Plasari, Aurel, *Letësia dhe muret*, Zëri i rinisë, Tiranë, 1993.
- [9]. Qosja, Rexhep, *Shkrimtarë dhe periudha*, ASHSH, Tiranë, 2005.
- [10]. Xhiku, Ali, *Letësia shqipe si polifoni*, Dituria, Tiranë 2004.

---

<sup>295</sup> Ismail Kadare, *Po aty*, f. 33.